

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 3 SHKURT 2022

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Është e vërtetë që sot po diskutojmë një marrëveshje për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore me Republikën e Greqisë, por nuk mund të rrimë pa folur dhe pa diskutuar për hallat e atyre qytetarëve që na kanë mandatuar. Pa dyshim që nuk vjen asgjë e keqe nga bashkëpunimi, sidomos nga bashkëpunimi midis shteteve fqinje. Në termat e sigurisë është veprimi i duhur, pikërisht në të mirën e dy vendeve tona, por meqenëse po flasim me termat e sigurisë dhe për sigurinë, nuk mund të mos themi, se politikat e shtetit shqiptar në lidhje me sigurinë janë të paplota. Siguria sot është totalisht e cenuar dhe e kërcënuar, ka mangësi themelore, dhe mund të themi se ka komplot kundër sigurisë së shqiptarëve. Po, ka një komplot dhe kjo është lakmia, e cila komploton me paaftësinë, me papërgjegjshmërinë dhe me mungesën e dashurisë për këtë popull. Ky komplot kundër sigurisë ka formën e një oktapodi, i cili i ka shtrirë tentakulat e tij në të gjitha fushat e jetës dhe nuk lejon që Shqipëria të ketë siguri dhe shqiptaret të ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre. Ndaj kemi këtë gjendje pasigurie sot. Siguria nuk nënkupton vetëm ushtrinë, vetëm policinë dhe vetëm Shërbimin Informativ.

Këto, pa dyshim, janë shtyllat kryesore me të cilat luftojmë kriminalitetin dhe pasojat e tij, por për të folur më gjerë për sigurinë, duhet të analizojmë me vëmendje të gjitha shkaqet dhe burimet që e shkaktojnë, e prodhojnë dhe e nxisin kriminalitetin dhe pasigurinë në vend. Cili është shkak kryesor, shkak i të gjitha shkaqeve, që sjell si pasojë cenimin e sigurisë? Pa dyshim, një ndër to është varfëria. Sipas Eurostat-it, për vitin 2021, Shqipëria është vendi me pagën minimale më të ulët në rajon, krahasuar me vendet e BE-së, po se po. E pra, varfëria është harruar dhe nuk flitet më për të. Sepse shumica e elitës politike është zhytur në luks, në pasuri, në udhëtime, në dreka dhe darka dhe nuk e shikojnë realitetin përreth tyre. Në fakt, realiteti i tyre nuk ka asnjë lidhje me realitetin e familjeve shqiptare. Por si e shkakton ky realitet kriminel dhe mungesën e sigurisë? Shpeshherë ndodh që dhuna brenda mureve të familjes të degradojë në vrasje të grave, për shkak të dëshpërimit, për shkak të grindjeve, të cilat kanë si shkëndijë, pikërisht varfërinë dhe pamundësinë ekonomike. Por e shkakton edhe në një mënyrë tjetër.

Sot ka adoleshentë, të cilët kanë synim të vetëm në jetë të largohen nga Shqipëria drejt vendeve të BE-së, për një jetë më të mirë, ku shumica e tyre vijnë nga familje të varfra. Kur shkojnë në shtëpi, shohin nënën e dëshpëruar, babanë e dëshpëruar, të cilët me zor u garantojnë bukën e gojës, shohin frigoriferin bosh, shohin që s'kanë para as për të blerë rroba, dhe fillon i bren ndërgjegjja nga brenda, ndihen të pavlerë dhe duan të shpërthejnë. Në fillim largohen nga Shqipëria si adoleshentë të dëshpëruar, por kthehen në Shqipëri si anëtarë të bandave, si kriminelë të rritur dhe me eksperiencë pune në grabitje, në vrasje dhe në narkotikë, duke cenuar sigurinë në vend. Shkak tjetër po aq kryesor është edhe shkolla, e cila në fakt është konceptuar për t'i edukuar fëmijët, për t'i rritur ata me parime njerëzore e qytetare, por që në realitet ka dështuar totalisht. E pse ka dështuar shkolla? Ka dështuar, sepse është kthyer në ndërmarrje partiake, politike për të punësuar militantët e partisë duke e bërë normalitet këtë fakt. Po ta gjykojmë me standardet e arsimit, me standardet dhe rregullat e punësimit

në arsim, dhe me logjikën e pedagogjisë dhe mësimdhënies, nuk ka asgjë normale, përkundrazi, është krim dhe atentat kundër brezave të ardhshëm. Nëse s'kam të drejtë, a mund të më shpjegoni, pse duhet të preket e gjithë struktura e arsimit, kur ndërrohet partia qeverisëse? Jo vetëm që preket, por ndërrohet edhe pastruesja e shkollës. Pra, është partia që ndërrohet deri te pastruesja e shkollës. E se çfarë lidhjeje ka arsimit me partinë, nuk ka asnjë shpjegim! Shkaku tjetër kryesor i cenimit të sigurisë është edhe mungesa e shërbimit shëndetësor. Mungesa e kujdesit dhe shërbimit shëndetësor shkakton një pasiguri shumë të madhe te qytetarët. Mendojnë për ditën kur mund të sëmuren, sepse duhen para për të paguar shërbimin shëndetësor dhe ilaçet. Dhe pastaj qëndron ajo shprehja: "Mos na çoftë Zoti në dyert e spitalit, se të lënë të vdesësh". Kjo shprehje ilustron më së miri pasigurinë e qytetarëve. Të nderuar kolegë, A i keni pyetur ndonjëherë shqiptarët, se cilat janë arsyt pse ata duan të largohen çdo ditë nga Shqipëria? Ose dërgojuni atë formularin e këshillimit kombëtar.

Meqë i pyesni për kanabisin, pyetini më mirë pse duan të largohen çdo ditë e më shumë nga vendi i tyre. Apo, sepse jua dini përgjigjet; duan të largohen se këtu nuk ka arsim, nuk ka shëndetësi, nuk ka punë, nuk ka para, pra nuk ka të ardhme e këtë përgjigje qeveria nuk dëshiron ta dëgjojë, pasi kjo përgjigje ia shemb të gjithë propagandën që ajo vetë ka ndërtuar. Le te ndalemi pak te siguria ushqimore. Pyesni njerëzit: a ndihen të sigurt me ushqimet e tregut? Domatja, thonë, është me helme dhe jashtë standardeve. Në fakt, nuk është domate, por thjesht emrin e ka të tillë. Qumështi, thonë, është me lloj-lloj pluhurash e përzierjesh, "qumësht" quhet, por në të vërtetë nuk është qumësht. Mishi, gjithashtu, "nuk e dimë çfarë hamë". A tregtohet mish nga Amerika Latine, i cili qëndron një vit nëpër kontenierë dhe askush nuk e kontrollon? E pra, shteti nuk i kryen detyrat e veta për të kontrolluar ushqimet, sepse me shumë mundësi importuesit paguajnë para për të mos ua kontrolluar produktin që fusin në tregun shqiptar. Dhe kështu, për shkak të korrupsionit të disa politikanëve dhe zyrtarëve kriminelë, të cilët pranojnë t'u shesin shqiptarëve ushqime të dëmshme, nuk jemi të sigurt në vendin tonë. Të mos flasim pastaj për sigurinë ekonomike dhe të punës. Në Shqipëri sot je në punë dhe nesër nuk je. Të largojnë nga puna dhe nuk ke asnjë mbrojtje, askund, nga askush, prandaj duhet të rrihsh urtë, duhet të durosh edhe shkeljen e të drejtave, edhe fyerjet, vetëm për të qëndruar në punë. Për të mos folur pastaj për nivelin e pagave. E ndërsa çmimet rriten çdo ditë, me 10%, 20% apo me 30%, pagat mbeten në vend numëro.

Në Shqipëri sot e ke biznesin, nesër nuk e ke. Ta mbyllin biznesin me fuqinë tatimore, se të presin një gjobë të lartë dhe të falimentojnë. Për çfarë sigurie mund të flasim ne? Jo me kot thonë: çmimet si në Gjermani, pagat si në Shqipëri. Fatkeqësisht, jetojmë në një vend ku ekonomia është e monopolizuar, ku po forcohen ekonomikisht e po pasurohen vetëm oligarkët afër qeverisë, ndërsa qytetarët duhet të ndihen me fat nëse mbijetojnë, nëse arrijnë të paguajnë faturat dhe detyrimet, se për mirëqenie as që bëhet fjalë. Kjo quhet "pasiguri ekonomike", sepse nuk dihet çfarë të ndodh nesër. Le të flasim pak edhe për sigurinë e pronës. Që prej ardhjes në pushtet, kjo njihet si "qeveria e fadromës dhe e shkatërrimeve të ndërtesave". Plane rregullimi, plane investimesh, rrugësh apo veprash parashikohen në të gjithë botën, por nuk kemi parë as në Gjermani, as në Itali, as në Belgjikë, as në Austri, që të tërhiqet zvarrë një grua e moshuar, siç u dhunua nënë Liza te "5 Maji" nga Policia e Shtetit. Kjo nuk ndodh, e kur ndodh dënohet. Nëse qeveria vendos të shembë disa banesa, sepse duhet ndërtuar një rrugë, zgjidhja është shumë e thjeshtë: ndiqet procesi i rregullt i shpronësimit dhe i kompensimit nga fillimi deri në fund, sipas vlerës reale të tregut, akomodohet dhe dëmshpërblehet familja e prekur dhe mbaron me kaq. Po të veprohet në këtë mënyrë, nuk do të kemi as skena të dhimbshme, as tërheqje zvarrë të njerëzve, as britma, as lot dhe as hedhje gazi, siç ndodhi në Shkozë. Por nuk e bëjnë këtë, sepse duan të prishin pronën qytetarëve dhe paratë të mos ua japin. Si mund të quhet tjetër kjo, përveçse qeveri e pasigurisë, e hajdutërisë dhe e terrorit? Të gjitha sa më sipër vijnë nga korrupsioni, lakmia për të vjedhur paratë e tjetrit, lakmia për t'u pasuruar pa punuar. Të gjitha zyrat e shtetit, nga ajo e Gjendjes Civile deri tek ajo e Kryeministrit, janë zyra të korrupsionit, të cilat funksionojnë për të

marrë dhe për të grumbulluar para. Në realitetin shqiptar kjo dihet, sepse shqiptarët e dinë, e ndiejnë, e prekin dhe jetojnë çdo ditë, por edhe institucionet monitoruese ndërkombëtare e kanë denoncuar Shqipërinë si vend të korrupsionit, vend ku politikanët dhe zyrtarët mendojnë vetëm për t'u vjedhur paratë shqiptarëve.

Prandaj vendi ynë klasifikohet si vend me pasiguri të lartë në të gjitha drejtimet, nga pasiguria për të blerë ushqimet, për të garantuar jetesën e deri te pasiguria nga kriminaliteti, trafiqet dhe bashkëpunimi i organizatave kriminale me institucionet e shtetit. Fatkeqësisht, ky është realiteti i hidhur shqiptar dhe ndaj largohen shqiptarët. Faleminderit!